



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:159783

Datë: 13.11.2024

Numri i dokumentit: 06495280

**2024:291322**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, gjyqtarin i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehuri Xh. R. nga fsh. ...., duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.143/24, të datës 07.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit në njërën anë dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KEDS-Qëndrim Sallahu në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Ferizaj PP/II.nr.724/24, të datës 15.10.2024, për shkak të veprës penale Vjedhja e Shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 13.11.2024 mori këtë:

#### **A K T V E N D I M**

**APROVOHET** marrëveshja ND.nr.143/24, e datës 07.11.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurit Xh. B. R. nga fsh .... K. Ferizaj, i lindur me dt....., me nr. personal ..... në njërën anë dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës KEDS-Qëndrim Sallahu, në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.724/24, e datës 15.10.2024 dhe PUSHON procedura penale kundër të pandehurit Xh. R., për shkak të veprës penale Vjedhja e Shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.724/24, të datës 15.10.2024, ka akuzuar të pandehurin për veprën penale Vjedhja e Shërbimeve nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin gjyqësor me dt. 04.11.2024, konform nenit 229 të KPPRK-së dhe nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datë 07.11.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja ND.nr.143/24, në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenit 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim në datën 13.11.2024, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 453 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë, e konform nenit 248 par. 1 pika 1.4 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**2024:291322, me dt. 13.11.2024.**

**Zyrtare ligjore**

**Kimete Bytyqi**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

**Imri Sejda**

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.